



MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK NË KOSOVË

PUNIM STUDIMOR 01


riinvest
debates



Përgatitur nga Muhamet Mustafa, Këshilltar Senior dhe Antigona Uka, hulumtuese në Institutin Riinvest, mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS



MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK NË KOSOVË

PUNIM STUDIMOR 01



Përgatitur nga Muhamet Mustafa, Këshilltar Senior dhe Antigona Uka, hulumtuese në Institutin Riinvest, mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS

"Qëndrim: Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit Riinvest dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur"

HYRJE

Qeveritë krijojnë borxh publik, të brendshëm dhe të jashtëm, për të financuar rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale me fonde shtesë ndaj atyre që sigurojnë nëpërmjet tatimeve dhe taksave. Të gjitha ekonomitë karakterizohen me një shkallë të caktuar të borxhit dhe varësisht nga politikat që ndjekin, kapacitetet e tyre absorbuese, niveli i qeverisjes makroekonomike, i shndërrojnë fondet e huazuara në rritje ekonomike e mirëqenie sociale, apo përballen me problemet e riskut të borxhit që në raste të caktuara i sjell ato në situatë ekstreme të përballjes me pamundësinë e kthimit e deri edhe te rreziku i falimentimit². Në këtë mënyrë qeverite mund të hyjnë në spiralen e rrezikshme të ngarkesës me borxhe kur duhet t'i riprogramojnë ato, apo kur duhet të hyjnë në borxhe të reja për t'i kthyer kreditë e marra më herët. Prandaj, menaxhimi i mirë i borxhit publik është një çështje thelbësore në kuadër të politikave makroekonomike e që ndërlidhet gjithashtu edhe me politikën fiskale dhe atë monetare. Për t'i arritur objektivat zhvillimore, të cilat të shumtën qëndrojnë prapa hyrjes në borxh, qeveritë dhe parlamentet krijojnë kornizën ligjore dhe krijojnë si dhe Strategjinë e menaxhimit të borxhit publik.

Qëllimi i këtij raporti të shkurtër³ është që t'i prezantojë ecuritë e borxhit publik të Republikës së Kosovës dhe çështjet aktuale të menaxhimit të tij. Kosova ka krijuar një kornizë bazike ligjore lidhur me borxhin publik (Ligji mbi Borxhin Publik dhe brenda tij elemente të Rregullës fiskale), si dhe Programin e Borxhit Shtetëror 2019-2021, por ende nuk e ka ndërtuar Strategjinë më afatgjatë të menaxhimit të borxhit publik. Qëllimi i një strategjie të tillë do të ishte jo vetëm që të mobilizohen fonde me koston më të ulët, por që struktura dhe kompozicioni i portfolios

së borxhit të jetë i atillë që t'i minimizojë risqet ndaj buxhetit dhe stabilitetit makroekonomik dhe financiar përgjatë një horizonti kohor afatmesëm dhe afatgjatë.

Duke marrë parasysh kontekstin historik borxhi publik i Kosovës ka dy komponentë: Borxhin e jashtëm i cili ndërlidhet me ish-Krahinën Autonome të Kosovës në kuadër të ish-Federatës Jugosllave i cili ende nuk është i definuar tërësisht, në mungesë të përfundimit të procesit të sukcesionit me Republikën e Serbisë⁴ dhe të ashtuquajturin borxhin e ri, i cili e ngarkon Kosovën pas shpalljes së pavarësisë.

Marrë në tërësi Republika e Kosovës ka një ngarkesë të ulët të borxhit publik, i cili tani, në bazë të të dhënave për kuartalin e tretë të vitit 2018 arrin diçka mbi 1 miliard euro ose afër 17% të GDP-së. Kjo është dukshëm më e ulët sesa në vendet e tjera në rajon ku ngarkimi me borxhe lëviz nga 38% Bosnjë e Hercegovina e deri në 71% Shqipëria dhe 74% Mali i Zi (shih Tabela 1, në Aneks). Megjithatë, duke filluar nga viti 2012 dinamika e rritjes së borxhit është shumë e theksuar, e që mund të shpjegohet me kontekstin historik dhe bazën e ulët. Megjithatë, kjo kërkon një vëmendje të shtuar të Qeverisë dhe akterëve tjerë lidhur me kapacitetin absorbues të Kosovës për ta transformuar këtë borxh në rritje ekonomike dhe mirëqenie sociale, përkatësisht lidhur me implikimet afatmesme dhe afatgjata të këtyre lëvizjeve në stabilitetin makroekonomik dhe fiskal. Pasqyra e mëposhtme mbi lëvizjen e borxhit publik dhe komponentëve të tij në krahasim me GDP-në shtron nevojën që tani e tutje t'i kushtohet një vëmendje e merituar të gjitha aspekteve të menaxhimit të borxhit publik:

² Shembulli i Greqisë këto vitet e fundit dhe i ish-Jugosllavisë në vitet 80' të shekullit të kaluar janë dy shembuj karakteristikë.

³ Raporti është shkruar si bazë nisëse për tryezën e parë, në serinë e dabateve mujore për ekonominë të titulluar "Debate në Riinvest", një projekt ky i mbështetur nga KFOS (Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur) më 30 janar 2019

⁴ Kjo komponentë e borxhit ende mbetet e padefinuar në mungesë të një marrëveshje suksesioni me Republikën e Serbisë dhe si e tillë nuk trajtohet në këtë Raport. Kur Kosova u bë anëtare e Bankës Botërore në vitin 2009, ajo duhej të merrte një shumë borxhi të trashëguar nga Jugosllavia që u shpenzua brenda territorit të Kosovës. Si e tillë, portofolio e borxhit shtetëror të Kosovës u krijua në vitin 2009, me një shumë prej rreth 400 milionë USD të quajtur Kredia e Konsoliduar C. Shuma më e madhe e këtij borxhi është nga BB dhe kategorizohet nën borxhin e vjetër të shtetit, i cili është ende në procesin e shpërgimit, me një afat maturimi deri në vitin 2035.



	2013	2017	Index
GDP (mil euro)	5,327	6,257	117
Borxhi publik	476	996	209
Borxhi i jashtëm	323	422	130
Borxhi i brendshëm	153	574	357

(LLOGARITUR SIPAS TABELËS 3 NË ANEKS, DHE PROGRAMIT TË BORXHIT SHETËROR, FAQE 8)

Fakti se brenda periudhës 2013-2017 kemi më tepër se një dyfishim të borxhit publik dhe një trefishim e gjysmë të borxhit të brendshëm dhe në kushtet e një rritjeje prej 17% të GDP-së brenda asaj periudhe shtrun domosdonë për kujdes të shtuar dhe sigurimin e një transparence lidhur me borxhin publik dhe përdorimin efektiv të tij nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit. Ky ka qenë edhe motivi kryesor i përgatitjes së këtij raporti të shkurtër dhe prezantimit të tij në tryezën "Debate në Riinvest", por edhe për iniciimin e një diskutimi të gjerë në institucione, në qarqe akademike dhe përgjithësisht në opinion, në mënyrë që të tërhiqet një vëmendje e shtuar e gjithë akterëve të interesuar lidhur me borxhin publik.

Raporti është përgatitur në bazë të të dhënave nga MEF-i, BQK-ja, ZKA-ja si dhe bisedave/intervistave në MF, në BB dhe me MZHE-në. Pas një prezantimi të shkurtër të diskutimeve teorike lidhur me menaxhimin e borxhit publik, raporti i bën një analizë të shkurtër Programit të Borxhit Shtetëror 2019-2021 dhe faktorëve të riskut që e shoqërojnë atë, trajtohet struktura sektoriale e destinimeve të borxhit dhe problemet e theksuara lidhur me menaxhimin e projekteve për të cilat është destinuar një pjesë e borxhit të jashtëm dhe përfundon me konkluzion dhe rekomandime.

1. EVIDENCË E SHKURTËR E LITERATURËS LIDHUR ME KORNIZËN E BORXHIT PUBLIK

Ekonomitë e ndryshme kanë një sërë opsionesh dhe instrumentesh për të krijuar politika dhe strategji të qëndrueshme të menaxhimit të borxhit në pajtim me nivelin e zhvillimit ekonomik të tyre (M. Melecki, WB, 2007; A. Pinkowski IMF 2017). Këto qëllime si dhe preferenca ndaj riskut (risc aversion) shërbejnë si një udhërrëfyes për të dizajnuar dhe zbatuar Strategjinë e menaxhimit të borxhit (IMF & WB 2001). Strategjia do të duhej t'i përcaktonte caqet e portfolios së borxhit publik, indikatorët për të detektuar dhe menaxhuar riskun dhe do të duhej të ishte një dokument publik. Hulumtimet empirike kanë indikuar se probabiliteti që vendet të cilat kanë një nivel borxhi mbi 100% të GDP-së, ngjashëm me ato që kanë nivel borxhi deri në 50% të kenë një strategji të menaxhimit të borxhit është më i vogël në krahasim me vendet e tjera. Por krahas nivelit të borxhit ndaj GDP-së, si indikatorë me rëndësi që duhet pasur parasysh në procesin e menaxhimit të borxhit janë pagesat për borxhe ndaj GDP-së, pagesat për interese ndaj GDP-së, struktura e borxhit dhe afati mesatar i maturimit. Rreziqet që këtu ndërlihen janë nëse me borxhin favorizohet konsumi vijues në llogari të investimeve si dhe nëse nuk sigurohet që norma e interesit për borxhe të jetë më e vogël sesa norma e rritjes ekonomike ($i < g$), kjo do të sillte një sforcim të spirales së borxhit dhe një rritje të taksave në të ardhmen për t'i paguar borxhet që merren tash⁵. Përderisa norma e interesit të paguar për borxhin publik është më e vogël sesa norma e rritjes ekonomike, ndikimi i borxhit në rritje ekonomike dhe mirëqenie sociale mund të jetë pozitiv (Blanchard, sipas J. Maza, 2019).

Çështja e menaxhimit të borxhit publik dhe aspekteve të qëndrueshmërisë në kuptimin e stabilitetit makroekonomik është bërë një fushë që po tërheq vërejtjen e shumë kërkuesve në zë, sigurisht edhe për faktin se me këtë

problem po përballen edhe ekonomitë e zhvilluara në të cilat borxhi ka arritur një nivel të 110% ndaj GDP-së (2016) në krahasim me 70% para krizës financiare (A. Pinkovski, 2017). Në këto nivele, vulnerabiliteti ndaj borxhit bëhet shumë i ndjeshëm edhe në kushte të recesioneve të rëndomta. Por këtu ka një rol të rëndësishëm jo vetëm niveli i borxhit, por gjithashtu edhe struktura valutore e tij kur lëvizjet në kursin e këmbimit (duke përfshirë edhe devalvimin), mund të rrisin ndjeshëm barrën e borxhit si dhe të krijojnë një presion të mëtutjeshëm ndaj kursit të këmbimit. Një diskutim tjetër interesant që ndërlihet me këtë është zhvilluar për nevojën e ndërlihdjes së borxhit publik me variablat si çmimet e mallrave, eksportet dhe GDP (Krugman 1988 dhe Froot 1989). Më tutje Barro (1995) ka sugjeruar edhe ndërlihdjen e emetimit të bondeve me GDP, bile edhe në rastet kur kanë një përqindje jo aq të lartë të stokut të borxhit, për të kontrolluar më mirë limitin e borxhit dhe për të pasur një ndikim më të favorshëm të politikës së tatimeve dhe taksave në mirëqenie. Një përqindje e lartë e bondeve ndaj GDP-së mund të përcillet me konsekuenca të zvogëlimit të asetëve konvencionale e pastaj edhe me një transferim të riskut te sektori privat dhe ndikim përcjellës në ciklin biznesor e deri te një tentim të manipulimit të të dhënave nga emetuesi i tyre.

Për të udhëhequr një politikë më të qëndrueshme të borxhit, në pajtim me aftësinë për të servisuar ato dhe nevojat zhvillimore, FMN-ja dhe Banka Botërore kanë zhvilluar "Kornizën e Qëndrueshmërisë së Borxhit" (DSF) për vendet me të ardhura të ulëta (IMF&WB 2018) si një lloj "Sistemi të paralajmërimit të hershëm" për të siguruar qëndrueshmërinë nën servisimin e borxhit dhe e ndërlihd atë me qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDG). Logjika e kësaj kornize mund të jetë e dobishme edhe për Kosovën, ndonëse ajo nuk bie në këtë kategori vendesh.

⁵ Shih diskutimin, përkatësisht prezantimin e pikëpamjeve lidhur me këtë, Blanchard, Krugman, Lewis: Bruegel Economic Blog (2019)

Kjo aq më parë kur një kornizë e tillë mund të përshtatet sipas nevojës së vendit të caktuar dhe synon të ndërlihdë edhe rolin e kreditorëve dhe donatorëve, i cili në këtë mënyrë do të vihej në funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë jo vetëm me servisimin e borxhit por edhe për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG)⁶. Njëpërmjet kësaj kornize synohet që të nxitet zhvillimi i kapacitetit të një vendi për ta absorbuar dhe menaxhuar borxhin e tij duke marrë parasysh edhe cilësinë e institucioneve dhe politikave që vlerësohet nga BB-ja sipas indeksit CPIA⁷ (Country Policy and Institution Assessment), e pastaj edhe një skenar bazik projeksionesh si dhe skenarët që reflektojnë risqet (plausible shocks) e të ngjashme.

Njëpërmjet kësaj kornize testohet niveli i riskut si (a) i vogël kur caqet (benchmarks) nuk janë të kaluara (b) risku i mesëm kur caqet janë tejkaluar por janë brenda skenarëve (c) risk i lartë kur caqet tejkalojnë edhe skenarin bazik dhe (d) kur situata është në një nivel kur ka tejkaluar aftësitë për të paguar borxhin (Debt distress) ndaj nevojitet një ristrukturim ose masa të tjera të ngjashme. Ndërlidhur me këtë është e nevojshme të theksohet se FMN-ja që nga fundi i qershorit 2015 e ka bërë efektive një politikë të re më gjithëpërfshirëse lidhur me limitet e borxhit publik, ndërlidhur me programet që financon Fondi, ku si ndryshim esencial ka qenë që kushtëzimi i financimit është zgjeruar për të përfshirë në nivelin e borxhit, jo vetëm borxhin e jashtëm, por edhe atë të brendshëm, e gjithashtu edhe borxhin koncesional dhe jokoncesional⁸. Më tutje Fondi ka aprovuar një normë unike diskonti prej 5% për të llogaritur vlerën e tashme të borxheve dhe të variablave të tjera të ndërlihdura.

6 The Debt Sustainability Framework for Low-Income Countries: IMF and WB:

	PV of external debt in percent of		External debt service in percent of		PV of total public debt in percent of
	GDP	Export	Exports	Revenue	GDP
Weak	30	140	10	14	35
Medium	40	180	15	18	55
Strong	55	240	21	23	70

7 CPIA, një instrument diagnostikues i Bankës Botërore i cili tenton të përfshijë cilësinë e politikave dhe institucioneve të vendeve të caktuara në bazë të 16 kriterëve të grupura në 4 klasterë si: menaxhimi ekonomik, politikat strukturale, politikat e inkluzionit social dhe institucionet e menaxhimit të sektorit publik, vlerësimi është nga 1 (i ulët) -6 (i lartë). Për vitin 2017 WB ka llogaritur CPIA për Kosovën në nivelin 3, ngjashëm me Shqipërinë me 2005, por më ulët se Moldavia ose Ruanda që kanë arritur 4! Një nivel i tillë do të ishte e pritur të arrihej brenda një periudhe 8-12 vjet në shoqëritë paskonfliktuoze <https://data.worldbank.org/indicator/IQ.CPA.ENVR.XQ>, Shih edhe M. Mustafa (CIPE 2008)

8 Një hua është koncesionale nëse ka brenda komponentin e grantit së paku 35%

2. PROGRAMI QEVERITAR I BORXHIT SHTETËROR DHE MENAXHIMI I RISKUT

Qeveria e Republikës së Kosovës krahas kornizës bazike ligjore që rregullon huamarrjen e ka të aprovuar edhe Programin e Borxhit Shtetëror (PBSH), i cili përmban karakteristikat e një dokumenti strategjik, ndonëse i referohet një periudhe trevjeçare (2019-2021)⁹. Objektivat e përcaktuara mundësojnë një kontroll të mbajtjes së nivelit dhe strukturës së borxhit brenda caqeve që do të duhej të siguronin një qëndrueshmëri dhe mbrojtje nga situatat incidentale. Ky dokument përmban dy objektiva kyçe: (1) Mbajtjen e kontrollit mbi ritmin e ndryshimit të parametrave të borxhit dhe (2) Zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Arritja e këtyre objektivave do të duhej të sigurohej me masat e përcaktuara dhe me kufijtë e riskut. Masat kanë të bëjnë me aprovimin e planeve vjetore dhe ndërlidhjen e tyre me politikat ekonomike, por pa i specifikuar më qartë këto politika, pastaj monitorimin e lartësisë dhe profilit të borxhit si dhe mbajtjen e parametrave për të kontrolluar riskun. Kur është fjala për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë masat e parashikuara janë politika e balancuar dhe e parashikueshme e huamarrjes dhe përzgjedhja e instrumenteve të reja të borxhit, krijimi i infrastrukturës ligjore për tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dhe përgatitjet për integrim në tregjet ndërkombëtare të letrave me vlerë. Megjithatë për arritjen e këtyre synimeve nuk kemi një operacionalizim, për dallim nga objektivi (1) ku specifikohen parametrat e mbrojtjes nga risku¹⁰ si:

- Pjesëmarrja e borxhit në valuta të tjera, përveç euros, kufizohet në deri 30%
- Normat e interesit variable kufizohet po ashtu në 30% të stokut të borxhit
- Borxhi i brendshëm me maturim deri në një vit kufizohet në deri 50% për të siguruar një afat mesatar maturimi më të gjatë se një vit

Këta tre parametra të cilat janë në linjë me standardet e menaxhimit të riskut e pastaj edhe përcaktimi i valutës (Euro), dhe kufizimi i borxhit publik në deri 40% të GDP-së sipas Ligjit mbi Borxhin Publik dhe obligimi i bartësve të projekteve për të paguar borxhin, paraqesin kufizimet bazë dhe elementare teknike të menaxhimit të borxhit publik në Kosovë. Programi në tërësi ndërlidhet me kufizimet dhe parametrat e përmendur, por krahas një horizonti më të gjatë kohor i mungon edhe ndërlidhja me politikat e tjera ekonomike dhe filozofinë zhvillimore, në kushtet e Kosovës, në mungesë të politikës monetare, ndërlidhja më domethënëse me politikën fiskale dhe me politikat tregtare, përkatësisht bilancin e pagesave dhe sidomos eksportin, siç sugjerohet edhe në evidencën e diskutimeve që u prezantua më lart.

⁹ Divizioni për Menaxhimin e Borxheve, 2018, Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021
¹⁰ Po aty, faqe 6



Portfolio e borxhit shtetëror bazuar në të dhënat e vitit 2017 mbetet brenda suazave të përcaktuara me objektiva dhe parametrat e kontrollit të riskut, me një pjesëmarrje të borxhit në GDP afro 17%, një ngritje e ndjeshme në krahasim me vitin 2013, kur kjo pjesëmarrje ishte afro 9%. Kështu borxhi i gjithmbarshëm publik në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018 ka arritur në diçka mbi 1 miliard euro. Më tutje nga të dhënat e prezantuara në PBSH shohim se mesatarja e ponderuar e normave të interesit për borxhin ndërkombëtar është 3% dhe atij të brendshëm 1%, përkatësisht 1.8% në tërësinë e portfolios e që është më e vogël sesa rritja ekonomike viteve të fundit e që është konsistente edhe me sugjerimet dhe diskutimet teorike. Afati i maturimit deri në një vit është po ashtu brenda parametrave (32.9%), por sfidohet me një strukturë më pak të volitshme të borxhi i brendshëm (47%), e që është afër limiteve të përcaktuara në program (50%). Po ashtu edhe të parametrat e riskut të lidhur me normat e interesit situata duket e mirë ngase 84% e borxhit të përgjithshëm është me normë fikse në saje të borxhit të brendshëm, por tek ai ndërkombëtar ky parametër është në nivel të 62% (me një përkeqësim në krahasim me 2016 (69.5%)), e që është mbi limitet e përcaktuara me program. Situata duket më mirë të pjesëmarrja e borxhit në euro ndaj valutave të tjera (84% ndaj 87% në vitin 2016), e që është një rrethanë pozitive në kushtet e lëvizjeve të tanishme të kursit të euros ndaj dollarit amerikan.

Kur është fjala te portfolio e borxhit të brendshëm zhvillimet janë mjaft dinamike dhe meritojnë një vëmendje serioze. Borxhi i brendshëm ka arritur në 668 milionë euro deri në fund të shtatorit (2018) dhe shënon me tepër se një dyfishim në krahasim me vitin 2014, si dhe mbi 60% të borxhit të përgjithshëm publik i servisuar nga sektori i brendshëm financiar, bankat, kompanitë e sigurimeve, Fondi pensional dhe institucionet publike. Kosova ka një pjesëmarrje dukshëm më të lartë të borxhit të brendshëm në krahasim me vendet në rajon¹¹. Një dinamikë më të ndjeshme të rritjes në tri vitet e fundit e kanë pasur letrat me vlerë me maturitet 3-7 vite, nga 45 milionë (2015) në 240 milionë (2017). Sado që ky është një fakt pozitiv kur është fjala për ngarkesat buxhetore për servisimin e borxhit të brendshëm, ky do të mund të ishte një risk nëse

borxhi i brendshëm afatgjatë do të përdorej vetëm për të mbuluar deficitin buxhetor në destinimin e mallrave e shërbimeve dhe transfereve e jo edhe financimin e investimeve kapitale. Qeveria duhet t'i kushtojë një vëmendje më të madhe dinamikës, strukturës dhe destinimeve të borxhit të brendshëm pasi që në të kundërtën me trendin e tashëm mund të sfidojë stabilitetin buxhetor të vendit në një horizont kohor afatmesëm e sidomos afatgjatë. Ndaj do të ishte e dobishme që dinamika e letrave me vlerë dhe interesi i paguar për letrat me vlerë me maturim më të gjatë se dy vjet të lidhet më shumë me dinamikën e rritjes së GDP-së dhe burimeve primare të të ardhurave të buxhetit të vendit.

Në linjën e lëvizjeve të prezantuar më lart edhe kostoja e servisimit të borxhit të përgjithshëm publik (borxhi kryesor, interesi, tarifa e zotimit, etj.), është rritur më tepër se tri herë brenda periudhës 2013 - 2017 (25,4 milionë në 77.3 milionë), e që përbën rreth 4.39 % të buxhetit.

Ky dokument ka marrë parasysh edhe zhvillimet makroekonomike në vitin 2017 dhe lëvizjet e pritura më tutje, megjithatë gjykuar sipas të dhënave të reja duket se norma e rritjes ekonomike ndodhi të jetë diçka më e vogël, ndërsa shpenzimet e supozuara buxhetore për vitin 2021 (2,394 milionë) do të ndodhin sipas të gjitha gjasave në vitin 2019¹². Duket se risku i rritjes së shpenzimeve buxhetore është i nënçmuar në këtë dokument e veçanërisht kur kemi parasysh lëvizjet e reja lidhur me transferet sociale dhe pagat në sektorin publik, të iniciuara midis të tjerash edhe me Ligjin e paralajmëruar që do të duhej ta rregullojë këtë fushë. Kjo do të mund t'i vinte në sprovë serioze edhe caqet e deficitit fiskal mbi të cilin mbështetet ky dokument të përkufizuar edhe me rregullën fiskale. Faktorët e riskut (varësia nga remitancat, problemet me energjinë, performanca e dobët e ndërmarrjeve publike, kapaciteti i kufizuar për zbatimin e projekteve kapitale, dhe çmimet eksportuese), duket të jenë mirë të evidentuara. Andaj edhe mund të evidentohet një optimizëm lidhur me menaxhimin e riskut brenda periudhës që përfshin ky program (2019-2021). Dhe kjo duket e bazuar kur është fjala për riskun e normave të këmbimit valutor, riskun e ndërlidhur me normat e interesit dhe riskun lidhur me

¹¹ Për shembull, pjesëmarrja e borxhit të brendshëm në borxhin e gjithmbarshëm publik në Mal të Zi është rreth 10% (Balkan Monitoring Finances, 2017)
¹² Minsitria e Financave, 2018, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021



rifinancimin e borxhit të brendshëm, por krahas kësaj ka edhe arsye të tjera për shqetsim.

Kosova ka një specifikë tjetër lidhur me borxhin publik, ngase në targetin për limitin e tij ndaj GDP-së (40%) hyjnë edhe garancitë ndaj ndërmarrjeve të sektorit publik, siç janë për shembull garancia ndaj Trafikut Urban në Prishtinë dhe sipas të gjitha gjasave edhe garancia që duhet t'i jepet Contur Global, lidhur me investimin në Termocentralin e ri, i cili mbi bazë të kontratës së nënshkruar, duhet të fillojë së ndërtuari në mars të këtij viti. Kjo do të ndikonte në një rikonfigurim të ndjeshëm të disa parametrave që i kishte supozuar edhe ky program qeveritar. Në këtë mënyrë garancive të lëshuara nga Qeveria, përkatësisht Republika e Kosovës, të cilat në fund të vitit 2017 arrinin 44 milionë euro, do t'u shtoheshin diku rreth 350 milionë garanci për investitorin Contur Global¹³ që kryesisht ka të bëjë me sigurinë e shitjes së energjisë së prodhuar në Termocentralin e ri me çmimet e garantuara. Me këtë garanci, nën kushtet e përcaktuara me rregullën fiskale, përkatësisht Ligjin mbi Borxhin Publik sipas projeksioneve të prezantuara në PBSH, qysh në vitin 2021¹⁴ do të arrihej një pjesëmarrje e borxhit të tërësishëm prej rreth 28% në GDP, do të arrinte një borxh të përgjithshëm afro 2,3 miliardë euro, në krahasim me rreth 1 miliard sa është tani. Kjo do të thotë se me një trend të tillë, dhe nën supozimin e kufizimeve të tashme ligjore, mundësia për të marrë borxhe të reja do të kufizohej që nga viti 2023 e sidomos që nga viti 2025. Kjo çështje duhet të adresohet që tani pasi që mund të ketë implikime serioze fiskale e edhe për

të mbajtur ritmin e domosdoshëm të nevojave të reja për huamarrje ose garanci për projekte të reja zhvillimore në infrastrukturë dhe për nevoja të tjera.

Projeksionet lidhur me burimet e huazimit ndërkombëtar përfshijnë BB-në, FMN-në, ANZH-në (Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit), EBRD-në dhe Bankën Investive Evropiane si dhe disa aranzhmane bilaterale me qeveritë e Gjermanisë, Austrisë, Francës dhe Hungarisë, në kushte brenda kufizimeve të përcaktuara për menaxhimin e risikut.¹⁵ Financimi i borxhit të brendshëm synohet të pësojë ndryshime nëpërmjet rritjes së peshës së fletobligacioneve me maturitet prej 2-10 vjet, në krahasim me bonot e thesarit të cilat dominonin në periudhën paraprake deri në vitin 2016. Në kuadër të financimit të brendshëm programi parasheh një risi që ka të bëjë me emetimin e obligacioneve me pakicë¹⁶ për të mobilizuar për qëllime zhvillimore sidomos remitencat e pse jo edhe kursimet dhe fondet individuale të qytetarëve të tjerë. Kjo do të kërkojë përgatitje adekuate për emetimin e obligacioneve në tregun e jashtëm Eurobondet, por do të ishte mirë që për ta bërë më efektive këtë mundësi të zhvillohet infrastruktura ligjore për të pasuruar format dhe instrumentet që mundësojnë një mobilizim dhe koncentrim më të madh të kapitalit financiar.

13 Bazuar në bisedën me ministrin e Zhvillimit Ekonomik

14 Sipas projeksioneve të Programi i Borxhit Shtetëror (PBSH), faqe 30

15 PBSH, faqe 27

16 PBSH faqe 31



3. POLITIKAT SEKTORIALE DHE BORXHI PUBLIK

Krahas nivelit të përgjithshëm të borxhit publik dhe faktorëve të riskut të adresuar më lart, strategjia e menaxhimit do të duhej të merrte më tepër tipare zhvillimore e që ka të bëjë me një strategji dhe metodologji të përzgjedhjes së sektorëve, përkatësisht projekteve, dhe të monitorimit efikas të zbatimit të tyre, për të siguruar efektet e pritura në rritjen ekonomike dhe në mirëqenien sociale. Në periudhën 2009-2018 janë kontraktuar fonde prej afro 610 milionë eurosh (Tabela 2 në Aneks). Prej tyre 69% janë të destinuara në infrastrukturë (rrugët- 37%, infrastruktura ujore 19% dhe hekurudha 13%), pastaj në energji 12%, bujqësi 6%, sektori publik 5%, arsimit, shëndetësia dhe eksporti nga 2% dhe sektori financiar 1%. Marrë në përgjithësi një strukturë e tillë sektoriale duket adekuate kur është fjala për krijimin e kushteve infrastrukturore dhe ngritjen e kapaciteteve humane që duhet ta mbështesin rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Sigurisht që lidhur me këtë nevojitet një analizë më e hollësishme dhe më e integruar në nivel makroekonomik dhe sektorial, përkatësisht mikroekonomik, lidhur me kapacitetet absorbuese në sektor të caktuar, pastaj rangimin e projekteve dhe rrjedhimisht edhe sektorëve sipas normës ekonomike e sociale të kthimit (economic rate of return, social rate of return), në mënyrë që të maksimizohen, përkatësisht të optimizohen efektet e këtyre projekteve në rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Sektori i infrastrukturës rrugore ka absorbuar edhe investime të mëdha (krahasuar me sektorët e tjerë, buxhetin e konsoliduar dhe GDP-në) dhe atë të investuara nga buxheti, jo gjithmonë me një rigorozitet të nevojshëm lidhur me koston dhe kthimin. Vetëm Rruga e Kombit, autostrada Ibrahim Rugova (Vërmicë-Besi) dhe rruga Prishtinë – Hani i Elezit (Arbër Xhaferi), rreth 1.7 miliard. Qeveria po vazhdon me një agresivitet edhe autostradën në drejtim të Gjilanit e duket se do të fillojë edhe autostradën e Dukagjinit (rreth 100km). Përgatitja e projekteve dhe zbatimi i tyre deri tani ka qenë i përcjell me improvizime (projek-

to duke ndërtuar) dhe kjo gjithsesi do të duhej tejkaluar për shkak të efekteve negative në kosto dhe menaxhim të projekteve. Do të ishte e këshillueshme që financimi i infrastrukturës të bëhet së paku pjesërisht me hua ndërkombëtare, që krahas lirimit të fondeve buxhetore për investime në arsim dhe shëndetësi do të siguronte edhe rregulla më rigorozë dhe standarde përkatëse të përgatitjeve dhe vlerësimit ekonomik të projekteve, procesit të prokurimit dhe zbatimit më efikas të tyre.

Duke marrë parasysh eksportin e vogël sidomos të mallrave dhe deficitin ende të lartë në këmbimin tregtar me botën e jashtme, si dhe problemin e gjenerimit të vendeve të punës, politikat ekonomike duhet të shqyrtojnë se, si edhe huazimi në mënyrë më të drejtpërdrejtë do të ishte në funksion të rritjes së eksportit dhe punësimit. Shteti do duhet të gjejë instrumente që t'i mbështetë projektet apo marrëveshjet midis institucioneve ndërkombëtare financiare, agjencive dhe bankave të jashtme me bankat në Kosovë për të financuar me kredi të volitshme në aspektin e normës së interesit, grace periodës dhe maturitetit për t'i kredituar bizneset private me performancë eksportuese në sektorët e industrive përpunuese, bujqësisë, turizmit dhe ICT. Një shembull të mirë që duhet ndjekur dhe përsosur për të zhvilluar më tej është paralajmërimi i një marrëveshje midis IBRD-së dhe Bankës ProCredit, ndërlidhur edhe me fondet IPA, për një linjë kreditore prej 20 milionë eurosh për industrinë eksportuese¹⁷. Natyrisht që shteti nuk ka nevojë ta ekspozojë borxhin e tij publik ndjeshëm në këtë sektor, por gjithsesi mund të gjenden mënyra për inkurajimin e iniciativave të ngjashme me këtë që e përshkruam më lart. Për këtë qëllim do të mund të sugjerohej edhe përgatitja e studimeve sektoriale për sektorët e përmendur mbi të cilat do të mund të ndërtoheshin politika dhe masa të bazuara më mirë për identifikimin e projekteve dhe menaxhimin e tyre.

17 Expressonline, 23 janar 2019

4. MENAXHIMI I CIKLIT TË PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA BORXHI PUBLIK

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit (2018) si dhe intervistat me MF-në dhe BB-në indikojnë për ndërmarrjen e masave për t'i ngritur kapacitetet për të sendërtuar përmirësime substanciale në ciklin e menaxhimit të projekteve që ndërlidhen me borxhin publik. Kjo ka të bëjë me të gjitha fazat e këtij cikli¹⁸.

Faza përgatitore e projekteve që ndërlidhet me politikat publike dhe zhvillimore ka të bëjë me studimet sektoriale, identifikimin e projekteve dhe studimet paraprake dhe atyre të fizibilitetit. Në periudhën e deritanishme këtë funksion kryesisht e kanë realizuar donatorët dhe kreditorët dhe ka munguar një rol proaktiv i domosdoshëm i bartësve të projekteve dhe institucioneve – ministrive, komunave, agjencive dhe ndërmarrjeve publike. Kjo është e domosdoshme ngase donatorët dhe kreditorët jo gjithëherë kanë domosdoshmërisht pasqyrën dhe ndjeshmërinë e plotë për prioritetet e politikave zhvillimore publike lidhur me investimet publike dhe aspektet e ndërlidhura makroekonomike dhe mikroekonomike. Kjo fazë do të mund të kontribuonte në maksimizimin e efekteve të kthimit nga projektet brenda burimeve të kufizuara për financimin e tyre nga borxhi publik i jashtëm dhe i brendshëm. Kjo do të optimizonte efektet zhvillimore, pasi që projektet e ranguar sipas efekteve të kthimit në bazë të analizës kosto-përfitime (cost-benefit) do të konkurronin për financim deri në nivelin e burimeve në disponim. Në këtë mënyrë do të rritej objektiviteti në përzgjedhjen dhe aprovimin e projekteve sipas treguesve dhe metodologjisë standarde ndërkombëtare të vlerësimit të projekteve si bazë për aprovimin dhe zbatimin e tyre. Dhe, kjo është njësoj e rëndësishme si për projektet që financohen nga borxhi publik ndërkombëtar dhe në mos më shumë edhe ato që financohen nga borxhi i brendshëm publik. Çfarëdo improvizimi dhe tejkalimi i standardeve dhe metodave në

fazën e përgatitjes së projekteve, krijon probleme dhe defekte serioze në fazën e zbatimit dhe sidomos eksploatimit, përkatësisht qëndrueshmërisë financiare të projektit.

Edhe faza e kontraktimit dhe sidomos ajo e zbatimit të projekteve duket se përballet me probleme serioze. Raporti tanimë i cituar i Zyrës Kombëtare të Auditimit jep arsye për shqetësime serioze. Tabela 7 e paraqitur në Aneks të këtij punimi paraqet listën e 10 projekteve të kontraktura dhe ratifikuara për financim në periudhën e 2013-2016 nga burime të ndryshme, me një vlerë prej afro 212 milionë eurosh. Deri në fund të vitit 2017 prej kësaj shume janë tërhequr për zbatim të projekteve vetëm 5.2 milionë, ose 3% e vlerës së kontraktuar. Rruga Prishtinë – Mitrovicë, projekti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe ai i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (efiçienca e energjisë dhe energjia e ripërtëritshme) janë kontraktuar në periudhën 2013-2015, por realizimi tyre silltet nga 0% deri në 15%. Ndërkaq te projektet e ratifikuara më 2016 (MASHT-i, Ministria e Infrastrukturës, Infracos dhe komunat Ferizaj, Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan) nuk ka filluar fare zbatimin, me përjashtim të MASHT-it, kur për dy vjet janë shfrytëzuar vetëm 4% nga vlera e huas, përkatësisht 330 mijë euro nga 9,38 milionë potenciale.

Efektet negative nga një situatë e tillë janë në dy rrafshje. Së pari kjo ndikon në zgjatjen e afatit të aktivizimit të projektit dhe vonesën e eksploatimit të tij, pra në mungesën totale të efekteve të planifikuara, përkatësisht të pritura nga projekti i caktuar e që në shumicën e rasteve e deformat dhe sjell në pyetje qëndrueshmërinë e pritur financiare nga projekti. Efekti i dytë negativ është se buxheti i Kosovës ngarkohet me një taksë (fee) për mjetet e zotuar dhe të pashfrytëzuara sipas dinamikës, për-

18 Më gjerësisht në Muhamet Mustafa: Menaxhimi i investimeve (planifikimi, analiza dhe vlerësimi), Riinvest 2009; Project Cycle, The World Bank Group A to Z 2016 Published: October 2015. Pages: 143b - 143b https://doi.org/10.1596/978-1-4648-0484-7/project_cycle



katësisht transheve të planifikuara. Në periudhën 2013-2017 kjo kosto, tërësisht e panevojshme, arrin 1,7 milion euro.¹⁹ Është më se e domosdoshme që kjo çështje të ngritët në nivele më të larta, ministri, Qeveri dhe Kuvend, që të përcaktohet përgjegjësia për këtë situatë dhe të merren masat për tejkalimin e këtyre dobësive dhe për ngritjen e kapaciteteve absorbuese të institucioneve për menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve të kontraktuara të borxhit publik ndërkombëtar. Përndryshe kjo deformon tërësisht pritjet lidhur me qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe konstatimeve në PBSH se Kosova nuk është e ekspozuar ndaj risqeve të borxhit publik të jashtëm. Shikuar në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë edhe një borxh prej 17% ndaj GDP-së mund ta rrezikojë më shumë stabilitetin makroekonomik dhe financiar nëse projektet përcillen me dobësi të tilla në menaxhim përgjatë ciklit të tyre, sesa vlerat e një borxhi publik edhe mbi 40% ndaj GDP-së, nëse projektet realizojnë efektet e pritura në periudhën e tyre të zbatimit dhe eksploatimit.

Për të nxjerrë mësim, përkatësisht një “feed back” dhe mësim nga përvojat, standardet profesionale kërkojnë që patjetër të zbatohet edhe faza përmbyllëse e menaxhimit të ciklit të projektit – Vlerësimi (evaluimi) ex-post i projekteve pasi të hyjnë në fazën eksploatimit, kur testohet realizimi i efekteve të pritura ekonomike e sociale dhe konstatohen shmangiet eventuale nga parametrat e planifikuar, shkaqet e këtyre shmangieve dhe e tërë kjo shërben si përvojë dhe mësim për t’i evituar dobësitë e paraqitura në menaxhimin e ciklit të projekteve të projektet e reja. Sa kemi mundur të shohim, kjo praktikë nuk zbatohet me përgjegjësinë e domosdoshme tek institucionet publike bartëse të borxhit publik në Kosovë.

Andaj duket se ndërtimi i kapaciteteve absorbuese dhe menaxhuese për ciklin e projektit në harmoni me standardet ndërkombëtare duket të jetë një detyrë urgjente dhe me prioritet të lartë.

¹⁹ PBSH 2019-2021, MF, faqe 13

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Ndonëse Republika e Kosovës ende ka një shkallë relativisht të ulët të ngarkesës me borxhin publik, dinamika dhe struktura e tij si dhe dobësitë e theksuara në menaxhimin e borxhit, veçanërisht lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e projekteve dhe shfrytëzimin e destinuar të tyre, shtrojnë nevojën për përmirësimin e organizimit institucional dhe rritjen e kapaciteteve absorbuese në nivel të Qeverisë, MF-së dhe zbatuesve të projekteve.
- Borxhi publik, veçanërisht komponenti i tij i brendshëm, ka arritur një intensitet dhe dinamikë dukshëm më të lartë sesa GDP-ja, ndaj PBSH-së, përkatësisht strategjia e menaxhimit të tij duhet patjetër të zhvillojë edhe komponentin afatmesëm dhe afatgjatë të implikimeve të tij në konfiguracionin e tij makroekonomik, në qëndrueshmërinë fiskale dhe efekteve në rritjen ekonomike e mirëqenien sociale.
- Dinamika e tashme e borxhit publik dhe ekspozime edhe me komponentin e garancive për ndërmarrje publike ose komuna për huat ndërkombëtare në një periudhë 3-4 vjeçare do ta bëjë të diskutueshëm limitin e ngarkesës prej 40% ndaj GDP-së ose do të pengojë huamarrjet e reja, andaj Qeveria pa vonesë duhet ta adresojë këtë çështje dhe implikimet e ndërlidhura me të.
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë një program masash dhe aktiviteteve për një rol më proaktiv në përgatitjen e projekteve në harmoni me prioritetet e zhvillimit ekonomik, punësimit dhe eksportit dhe të vendosë rregulla strikte se huat publike mund të përdoren vetëm për projekte që janë përgatitur mirë me studime fizibiliteti dhe kapacitete zbatuese dhe të cilat i kalojnë testet e fizibilitetit në aspektin e kthimit të investimeve, bazuar edhe në analizat kosto-përfitime sipas metodologjisë standarde ndërkombëtare.
- Situata lidhur me dinamikën e zbatimit të projekteve të ndërlidhura me huat e kontraktuara është bren-gosëse dhe shtron nevojën për transparencë dhe llogaridhënie nga agjencitë e zbatimit.



REFERENCAT

Alex Pienkowski: Debt Limits and the Structure of Public Debt, IMF Working Paper 2017

Analysis on Public Debt Montenegro, Balkan Monitoring Finances, 2017

Barr, D., Bush, O., and Pienkowski, A., 2014, "GDP-linked Bonds and Sovereign Default," Bank of England Working Paper 484 (United Kingdom).

Blanchard, O. P. Mauro, and J. Acalin, 2016, "The Case for Growth Indexed Bonds in Advanced Economies Today," Peterson Institute for International Economics, Policy Brief No. 16–2

Debt Sustainability Analysis Report 2016/17 Ministry of Finance, Planning and Economic Development of Uganda (December 2017)

Debt Sustainability Framework for Low-Income Countries: IMF and the World Bank, August (2018)

Jan Mazza: Is Public Debt a Cheap Lunch, Bruegel Economic Review Blog, January 2019

Krugman, P. 1988, "Financing vs. Forgiving a Debt Overhang," Working Paper No. 2486.

Martin Melecky: A Cross-Country Analysis of Public Debt Management Strategies*, Policy Research Working Paper, WB 2007

Muhamet Mustafa: Menaxhimi i Investimeve (Planifikimi, analiza dhe vlerësimi), Riinvest 2009

Ministria e Financave, Divizioni per Menaxhimin e Borxheve, 2018, Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/03B56B8C-E056-4426-A7D2-67B902E48167.pdf>

Project Cycle, The World Bank Group A to Z 2016 Published: October 2015 Pages: 143b - 143b https://doi.org/10.1596/978-1-4648-0484-7_project_cycle

Zyra Kombëtare e Auditimit: Raporti i Auditimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollat e Borxheve Publike për periudhën 2009-2017, ZKA 2018

ANNEX: TABELAT

TAB. 1 BORXHI PUBLIK NË KRAHASIM ME RAJONIN

Borxhi i përgjithshëm % e GDP-së	2016	2017	2018
Kosova	14.58%	16.63%	16.92%
Bosnjë e Hercegovina	44.10%	39.50%	38.30%
Maqedonia	39.50%	39.30%	41.50%
Serbia	73.10%	62.50%	58.80%
Shqipëria	73.20%	71.80%	71%
Mali i Zi	66.40%	67.20%	74.20%

BURIMI: INTERNATIONAL MONETARY FUND, DATA MAPPER, 2018

TAB. 2 TË DHËNAT E BORXHIT NDËRKOMBËTAR SIPAS SEKTORËVE

Llojet e sektorëve	Shuma e fondeve të kontraktuara nga viti 2009 deri 2018	Shuma e fondeve të kontraktuara nga viti 2009 deri 2018 ne %
Spektori i Infrastrukturës Rrugore	226.83	37%
Spektori i Infrastrukturës Ujore	114	19%
Spektori Hekurudhor	81.9	13%
Spektori i Energjisë	67.45	11%
Spektori i Bujqësisë	36.34	6%
Spektori Publik	28.91	5%
Spektori i Shëndetësisë	15.2	2%
Spektori i Arsimit	14.52	2%
Spektori i Eksportit	14.3	2%
Spektori Financiar	5.22	1%
Spektori i Ngrohjes Qendrore	5	1%
Gjithsej	609.67	100%

BURIMI: MINISTRIA E FINANCAVE, DEPARTAMENTI I THESARIT, 2018

**TAB. 3 BORXHI PUBLIK NËPËR VITE**

	2013	2014	2015	2016	2017	2018 (TM3)
Borxhi ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15	416.59
Borxhi i brendshëm	152.51	256.52	377.78	478.78	574.27	663.50
Gjithsej borxhi i përgjithshëm	476.27	582.87	748.95	852.55	996.42	1080.09
Gjithsej borxhi i përgjithshëm (% e GDP-së)	8.49%	10.65%	13.07%	14.58%	16.63%	16.92%

BURIMI: BULETINI VJETOR 2017 MBI BORXHIN PUBLIK, MINISTRIA E FINANCAVE, 2018

TAB. 4 BORXHI NDËRKOMBËTAR NËPËR VITE SIPAS KREDITORËVE

Kreditori	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
BNRZh	149.01	238.33	226.34	215.00	203.66	129.33	180.99	169.65	158.32
ANZh	0	0	5.06	8.41	12.37	20.84	28.86	36.02	41.12
FMN	0	21.76	22.26	113.05	105.73	101.73	127.74	113.96	160.77
UniCredit	0	0	0	0	0	2.00	2.96	6.49	7.04
KfW	0	0	0.05	0.14	2.00	9.46	30.62	47.64	54.81
BIZh	0	0	0	0	0	0	0	0	0.10
Gjithsej	249.01	260.08	336.60	336.60	323.76	323.76	371.17	373.77	422.15

BURIMI: BULETINI VJETOR 2017 MBI BORXHIN PUBLIK, MINISTRIA E FINANCAVE, 2018



TAB. 5 MBAJTËSIT E LETRAVE ME VLERË

Mbajtësit e letrave me vlerë	2015	2016	2017
Bankat komerciale	227.36	238.92	243.42
Fondet pensionale	95.87	79.93	104.10
Institucionet publike	26.56	127.33	198.74
Kompanitë e sigurimeve	20.36	20.25	21.52
Të tjerë	10.40	13.52	7.17
Gjithsej	380.55	479.95	574.95

BURIMI: BULETINI VJETOR 2017 MBI BORXHIN PUBLIK, MINISTRIA E FINANCAVE, 2018

TAB. 6 SHËRBIMI I BORXHIT NGA TË HYRAT TOTALE TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS

	2013	2014	2015	2016	2017
Shërbimi i borxhit ndërkombëtar/Të hyrat totale %	1.7	2.23	2.33	4.37	4.01
Shërbimi i borxhit të brendshëm/Të hyrat totale %	0.09	0.17	0.32	0.45	0.38

BURIMI: BULETINI VJETOR 2017 MBI BORXHIN PUBLIK, MINISTRIA E FINANCAVE, 2018

TAB. 7 BORXHI NDËRKOMBËTAR NËPËR VITE SIPAS KREDITORËVE

Nr.	Kreditori	Kreditë	Viti i ratifikimit	OB zbatuese	Shuma e kredisë euro	Tërheqjet deri më 2016	Tërheqjet në 2017	Shuma e patërhequr	% e perealizuar
1	BIZh	Financimi i Projektit për përmirësimin e rrugës M2 Milloshevë – Mitrovicë	2013	MI	15.67	-	0.10	15.57	99%
2	FOZhN	Projekti i zgjerimit të magjistrales M2 Milloshevë-Mitrovicë	2014	MI	16.64	-	-	16.64	100%
3	FSZh	Projekti për magjistralen Prishtinë-Mitrovicë	2014	MI	13.31	-	-	13.31	100%
4	ANZh	Projekti i Shëndetësisë	2015	MSh	19.60	0.09	2.11	17.40	89%
5	ANZh	Projekti për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme	2015	MZHE	23.87	0.94	2.75	20.18	85%
6	ANZh	Projekti për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit në Kosovë	2016	MASHT	9.38	0.05	0.28	9.05	96%
7	BERZh	Rehabilitimi i rrugëve rajonale	2016	MI	29.00	-	-	29.00	100%
8	BEI	Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10	2016	MI, Infrakos	42.00	-	-	42.00	100%
9	BERZh	Projekti i Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10	2016	Infrakos	39.90	-	-	39.90	100%
10	KfW	Projekti për Masat e Energjisë Eficiente në komuna (Pr, FE, GJ, GJi)	2016		2.50	-	-	2.50	100%
Gjithsej:					211.87	1.08	5.24	205.55	97%

BURIMI: RAPORTI I AUDITIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLET E BORXHEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN 2009-2017, ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT, 2018

